



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

## Kryeministri Rama dhe ministri Gjicknuri në kantierin e HEC Moglicës

2017-11-13 11:41:00



HEC-i i Moglicës, një nga dy hidrocentralet e kaskadës së Devollit, në 2019 do të hedhë në rrjet energjinë e prodhuar, duke përfunduar kapacitetet prodhuese në vend. Punimet janë brenda parashikimeve dhe kjo iu bë e ditur Kryeministrit Edi Rama nga drejtuesit e kompanisë, gjatë inspektimit që Kryeministri, sëbashku me ministrin e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Damian Gjicknuri, bëri sot në këtë vepër.?

“Do të fillojmë me mbushjen e digës vitin tjetër, në 2018 dhe do të shkojmë më tej me prodhimin gjatë pranverës së vitit 2019 dhe në fund të vitit 2019 do të përfundojë gjithçka,” – u shpreh një nga drejtuesit e Statkraft.

Me kapacitet të instaluar 256 Më, HEC-i i Moglicës rrit kapacitetet prodhuese të energjisë në vend me 700 Gëh dhe e gjithë kaskada e Devollit do të rrisë me 17% furnizimin me energji. HEC-i i Moglicës është një vepër unike në projektim e ndërtim. Për herë të parë, diga e Moglicës do të lidhet me centralin e prodhimit nëpërmjet një tuneli 11 km të gjatë, i cili do të ndërtohet brenda në shkëmb.

“11 kilometra tunele nga këtu te centrali i prodhimit, i cili do të jetë nëntokë. Ky do të jetë centrali i parë i ndërtuar në Shqipëria nëntokë,” – u shpjegoi një nga drejtuesit e punimeve.

Po ashtu, me një lartësi prej 160 metrash, diga e Moglicës është një ndër digat më të lartë në botë në llojin e saj.

“Është një ndër më të lartët në llojin e tij. Mendoj se është vetëm një në Kinë që është pak më e lartë, por është thuajse e njëjta. Është një ndërtim unikal dhe shumë i madh,” – theksoi një nga inxhinierët zbatues.

Për ndërtimin e kësaj vepre aktualisht janë angazhuar rreth 1400 punonjës. “Përafërsisht, duke përfshirë edhe rrugët zëvendësuese, janë 1300-1400 njerëz,” - u shpreh një nga inxhinierët zbatues.

Përveç investimit në veprën energjetike, kompania ka investuar 60 milionë euro në infrastrukturën rrugore, duke iu ardhur në ndihmë banorëve të zonës së Devollit.